



INSTITUCIONET E PERKOHSHME VETE QEVERISESE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVES – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCES DHE TEKNOLOGJISE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

UDHËZIM ADMINISTRATIV

**LËNDA: REGJISTRIMI I NXËNËSVE NË VITIN E 10-të, TË ARDHUR
NGA VENDET TJERA.**

NR.MASHT 16 /2003

DT:01.09.2003

Në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika (d), nenit 42 paragrafi 1, nenit 8 paragrafi 1,2,3,4 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë dhe Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) nxjerrë këtë Udhëzim Administrativ:

Neni 1.

Qëllimi.

- 1.1. Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të rregullojë mënyrën e regjistrimit të nxënësve në vitin e 10-të, të ardhur nga Shqipëria dhe ishrepublikat jugosllave të cilët e kanë mbaruar vitin e parë(I) të shkollave të mesme me sistem të vjetër.

Neni 2.

Regjistrimi

- 2.1.. Nxënësi nga neni 1.1 mund të regjistrohet me kusht në vitin e 10-të, në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë.

Neni 3. Obligimet.

- 3 . 1 . Nxënësi i cili është regjistruar me kusht në vitin e 10-të, është i obliguar t'u nënshtrohet provimeve plotësuse nga viti i 9-të.

Neni 4. Provimet plotësuse.

- 4 . 1 . Lëndët nga të cilat duhet t'u nënshtrohet nxënësi provimeve plotësuese i cakton zyrtari i lartë Rajonal i Arsimit duke bërë krahasimin e dëftesës së marrë jashtë me lëndët e klasës së 9-të.

Neni 5. Afatet.

- 5 . 1 . Afati i provimeve plotësuese është shtatori dhe janari.

Neni 6. Statusi.

- 6 . 1 . Nëse nxënësi i mbaron me sukses provimet plotësuse në afatin e shtatorit vazhdon të vlerësohet dhe notohet sikur nxënësit tjerë.
- 6 . 2 . Nxënësi i cili i mbaron provimet në afatin e janarit vlerësohet dhe notohet në gjysmë-vjetorin e dytë.
- 6 . 3 . Gjatë vlerësimit dhe notimit në gjysmëvjetorin e dytë, arsimtari është i obliguar t'i pyes nxënësit edhe nga përmbajtjet programore të gjysmëvjetorit të parë.
- 6 . 4 . Nxënësi i cili nuk i mbaron provimet në afatin e janarit,ka të drejtë t'i vazhdojë provimet plotësuse në qeshor dhe gusht,por e humb vitin e regjistruar me kusht.

Neni 7. Plotësimi i dëftesës

- 7.1. Nxënësi i cili provimet plotësuse i mbaron me sukses pozitiv, notat i shënohen në anën e kundërt të dëftesës së marrë jashtë Kosove.
- 7.2. Dëftesa nga neni 7.1. duhet të përmbajë:
- Numrin e Udhëzimit Administrativ, me të cilin lejohen provimet plotësuse dhe data e lëshimit të Udhëzimit Administrativ,
 - Lëndët dhe suksesi i arritur sipas lëndëve,
 - Suksesi i përgjithshëm i klasës së nëntë,
 - Nënshkrimi I drejtorit dhe vula.

Neni 8. Hyrja në fuqi.

- 8.1. Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Isuf Zeneli, Sekretar i Përhershëm i MASHT-it

